



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1525 Regj
Nr.4346 Prot

Tiranë, më 02.12.2020

URDHËR
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓
Adresa: Tirane
Per dijeni: “OMER FRUIT” Sh.p.k Nipt L82715001M
Adresa: Fier, Lushnje, Lagjja Sarave, Rruga Nationale rrotondo e Plukut-Lushnje-Fier km 3
(Telefon: 0696267658)
Per dijeni: “Pik Industry” Sh.p.k, Nipt L44324401A
Adresa: Autostrada Lushje Fier, km 1, Fier,

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Përmbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 482 (64-2020-2076), date 02.11.2020, i Gjykates se Rrethit Gjyqësore Lushnje, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1525, Datë 09.11.2020 kërkesën e kreditorit “Pik Industry” Sh.p.k, Nipt L44324401A ndaj debitorit “OMER FRUIT” Sh.p.k Nipt L82715001M, në lidhje me titullin ekzekutiv:

- “Fature tatimore e shitjes” Nr. 1306, date 10.09.2020, me Nr. Serie 91917211;
- “Fature tatimore e shitjes” Nr. 1314, date 11.09.2020, me Nr. Serie 91917219.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 4030 Prot, Datë 09.11.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr. 482 (64-2020-2076), date 02.11.2020, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori “OMER FRUIT” Sh.p.k Nipt L82715001M, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit “OMER FRUIT” Sh.p.k Nipt L82715001M, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qëllim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore “OMER FRUIT” Sh.p.k Nipt L82715001M, me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregëtar.

2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI

